



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

**LËNDA: LATINISHT**

Pedagogu: Prof.As.Dr.. Leonard Xhemani  
Ngarkesa: 6 ETCS (15 javë - 2 leksione 1seminare në javë)  
Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje  
Viti/Semestri : II/I

**Përshkrimi :** Programi synon në përvetësimin e njohurive bazë në fushë të gjuhës dhe kulturës latine, veçanërisht të periudhës që lidhet me latinishten klasike dhe atë postklasike. Do të trajtohen nocione themelore të prozodisë, fonologjisë dhe historikut të alfabetit latin. Do të trajtohet gjithashtu historia e Romës nëpërmjet teksteve të autorëve më përfaqësues të shekullit të parë para Krishtit dhe arsenali i proverbbave dhe thënieve sentenciale, shprehje e një qytetërimi që mori por dhe asimiloi në mënyrë origjinale nga të tjera qytetërimë.

**TEMAT E LEKSIONEVE:**

1. Gjuha latine, gjuhë i.e. një gjuhë indoevropiane në një truall italik. Veçori të zhvillimit të gjuhës latine në Romë, nga periudhat më të hershme në periudhën e Cezarit dhe Ciceronit.
2. Dokumentet e para shkrimore të gjuhës latine, çështje të analizimit të autenticitetit të tyre. Gjuha latine dhe greqishtja e vjetër, gjuhë të një areali kulturor kufitar.
3. Njohuri mbi fonetikën dhe fonologjinë latine. Elemente bazë të fonologjisë latine : nga zanoret e diftongjet te bashkëtingëlloret. Veçori të pronuntias scientifica (restituta), ecclesiastica.
4. Morfologjia latine: pjesë të ligjëratës dhe çështje të eptimit emëror dhe foljor.
5. Morfologji: emrat dhe ndarja në lakime. Paradigmat kryesore: veçanti dhe përjashtime.
6. Gjymtyrë të tjera emërore: çështje të eptimit të tyre në latinishten klasike.
7. Qytetërimi latin në tekstet e autorëve latinë të shekullit të parë para Krishtit: Salusti, Ciceroni, Cezari.
8. Qytetërimi latin në tekstet e autorëve latinë të shekullit të parë para Krishtit: Periudha e Augustit dhe autorët latinë përfaqësues.

- 9: Besimi në botën e Romës së vjetër: analizë tekstesh latine; Ciceroni, Virgjili.
10. Figura e gruas në Romën e vjetër. Analizë tekstesh latine (antologji e letërsisë latine: pjesë nga Ciceroni dhe autorë të tjerë).
11. Nociione të qytetërimit latin në proverba e thënie latine: Publil Siri.
12. Nociione të qytetërimit latin në proverba e thënie latine: Ciceroni, Seneka, Horaci.
13. Miqësia në proverba e thënie latine. (citime autorësh).
14. Etimologjia latine në terma të besimit, elokuencës, letërsisë dhe fushave të tjera të dijes.
15. Etimologjia latine në terma të besimit, elokuencës, letërsisë dhe fushave të tjera të dijes.

#### **FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**

**FREKUENTIMI:** 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

*15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

*25 % e notës përfundimtare.*

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New

Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

*20 % e notës përfundimtare*

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*40 % e notës përfundimtare*

#### **LITERATURA:**

1. BARBIERI G., LEGGERE OGGI GLI AUTORI LATINI, LOESCHER EDITORE, TORINO, 2000.

2. FLOCCHINI N., GLI SCRITTORI LATINI, EDIZIONI PARAVIA, TORINO, 2000.

3. BETTINI M., LA LETTERATURA LATINA, STORIA LETTERARIA E ANTROPOLOGIA ROMANA (PROFILO E TESTI DALLE ORIGINI ALLA CRISI DELLA REPUBBLICA), LA NUOVA ITALIA, FIRENZE, 1995.

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc.dr. Eva Tafili